



Procesverbal 1/2024

I mbajtur në mbledhjen e I-rë të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e z.Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën 30.01.2024 ne ora 10. 00 në zyrën e takimeve te Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Mirësearchje dhe njoftim i anëtarit të ri në Komitetin për komunitete z. Amir Rexhepi;
5. Propozimi i aktiviteteve dhe përgatitja e Planit të punës së Komitetit për komunitete dhe
6. Të ndryshme.

1. **Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini** – Konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje – Prezent ish-in të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete;
2. U Miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;
3. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Uron mirësearchjen z. Amir Rexhepit si anëtar i ri i Komitetit për komunitete.

Amir Rexhepi – Prezentohet dhe mban fjalim rasti.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Të përgatitet një plan pune si dhe të ipen disa aktivitete të cilat do të jenë në Plan pune.

Jeton Lika – Të jenë disa aktivitete të cilat kanë mbetur nga viti i kaluar i Komitetit për komunitete meqense Komiteti për komunitete së Ferizajt është më i miri në rajon.

Flora Abdulladu – Të frekuentohen shkallët ku janë nxënësit të komuniteteve të Q.K.M.F., Komiteti të informohet për shërbimet të cilat ipen

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Të takohemi me Komitete tjara të komunave tjera.

Flora Abdullahu – Të ndahet një buxhet për Komitetin për komunitete për shkak të aktiviteteve.

Jeton Lika – Nuk duhet të ketë kod të veçantë, mendoj se Komiteti për komunitete është objektiv.

Silvana Macak – Nuk kam ndonjë kërkesë momentalisht.

Jeton Lika – Të raportoi zyra e Komitetit për komunitete një herë në 3 ose 6 muaj.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Vizitë Drejtorive, thirrja e drejtorave për raportim të informohemi ku mund të intervenojmë.

Flora Abdullahu – Një nga takimet që kemi pasur me gratë e komuniteteve, kërkesë ka qenë subvencionimi dhe asistenca sociale.

Amir Rexhepi – Të vizitohen shkollat, përkatësisht në fshatin Koshare ku ka komunitet, të bisedohet me Drejtorin e bujqësisë të shikohet a marrin ndihma.

Flora Abdullahu – Të vizitohet Qendra sociale në Dubravë.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – të ndihen të lirë anëtarët e KK-së që propozojnë pika për rend dite ose diskutim.

Të ndryshme – Të diskutohet për procesmbajtës për shkak se anëtarët detyrohen të mbajnë procesverbalin dhe janë të mangët në diskutim.

Silvana Macak – Jam e kënaqur me kolegët e Komitetit për komunitete për punën që bëjnë për të ndihmuar njëri-zit. Jam e interesuar që a ka persona të komunitetit serb në Komunën e Ferizajt, mirëpo nuk ka në Bablak e në disa fshatra për rreth është mirë të vizitohen.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Të organizohet një vizitë në fshatrat ku ka komunitet serb.

Procesmbajtësi
per Xhemajl Jashari
Xhemajl Jashari

Kryesuesi i Komitetit për komunitete
Osman Emini

